

Ministri

Znj. Mirela Kumbaro Furxhi ka lindur në Tiranë, në vitin 1966.

Ajo mban titullin Profesore e Asociuar, të fituar në vitin 2012 në Universitetin e Tiranës, në fushën e gjuhësisë. Në vitin 2009 ka mbrojtur titullin Doktor i Shkencave në fushën e Studimeve Përkthimore pranë Universitetit të Tiranës. Ka mbrojtur Diplomën për Master në Përkthim dhe Komunikim Ndërkulturor në vitin 1994, në E.S.I.T - Paris III, Universiteti i Sorbonne - Nouvelle, në Paris, Francë. Ka kryer studimet universitare dhe është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në fushën e letrave frënge, në vitin 1988.

Znj. Mirela Kumbaro Furxhi nuk vjen nga radhët e politikës, por nga karriera akademike dhe nga një angazhim i gjatë e aktiv në shoqërinë civile ku ka kontribuar në fushat e kulturës, arsimit dhe problemeve sociale.

Znj. Kumbaro është përkthyes, publiciste dhe eksperte ndërkombëtare për projekte ndërkulturore dhe për programe kërkimore universitare, të ndërmarra nga organizatat ndërkombëtare si Bashkimi Evropian, Organizata Ndërkombëtare e Frankonisë.

Ajo zotëron shumë mirë frëngjishten dhe italishten, si dhe mjaftueshëm anglishten.

Zv/minister

Z.Zef Çuni ka lindur në qytetin e Shkodrës në vitin 1956. Ka kryer studimet e larta me rezultate të shkëlqyera në degën e Arkitekturës në Universitetin e Tiranës në vitin 1981. Është specializuar në Danimarkë për Sociologji Urbane dhe institucionet shkollore.

Z.Çuni është angazhuar në politikë që në vitin 1992 dhe ka qënë anëtar i Këshillit Bashkiak të Shkodrës në vitet 1992-1996 dhe në vitet 2004 – 2007 si dhe kandidat për deputet i PS në vitin 2005 dhe 2013.

Z.Cuni ka një karrierë të pasur në fushën e arkitekturës, artit, sportit dhe shoqërisë civile.. Ai ka qënë për 10 vite drejtor i degës Rajonale të Monumenteve të Kulturës në Shkodër dhe është restaurator i Kalasë Rozafat, shtëpisë së Oso Kukës dhe dhjetra objekteve në veriun e Shqipërisë.Ka qënë ekspert i Shoqates “Red Barnet” për investimet e qeverisë Daneze në Shqipëri. Ka qënë anëtar i bordit të projektit “Qytetet Krijuese” CREATIVE CITY 2004-2008 i mbështetur nga programi zvicerian për kulturën. Zbatues i nismave: Rivitalizimi i fasadave tradicionale, debate publike mbi administrimin krijues të qyteteve Bashkia Shkodër- Tiranë. Ka qënë futbollist me Vllazninë dhe Dinamon. Z.Cuni është i dekoruar me medaljen “Naim Frasheri” nga Presidiumi i Kuvendit Popullor në vitin 1989 ,për restaurimin me cilësi të Kalasë së Shkodrës dhe organizim të mirë të punës në sektorin ku punonte.

Z.Çuni zotëron gjuhën angleze dhe italiane.

Email: zef.cuni@kultura.gov.al

Sekretar i pergjithshem

Znj. Elira Kokona është diplomuar në fushën e drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës Fakulteti i Drejtësisë dhe Universitetit “La Sapienza” Romë duke përfunduar studimet master për të drejtë ndërkombëtare. Anëtare e Dhomës Kombëtare të Avokatisë në Shqipëri prej vitit 2004 dhe në atë italiane prej vitit 2005, znj. Kokona ka një karrierë të pasur si avokate e asociuar në studio ligjore në Tiranë dhe Romë. Prej vitesh ka punuar si eksperte ligjore dhe këshilltare programi në Gjykatën Evropian të Drejtave të Njeriut në Strasburg dhe në

Drejtorinë e Përgjithshme të Drejtave të Njeriut dhe Punëve Ligjore në Këshillin e Evropës në Strasburg. Lektore e të Drejtave të Njeriut dhe GJEND, në shkollën e magistraturës, fakultete juridike si dhe programe studimi të së drejtave të njeriut, znj. Kokona ka publikuar një sërë artikuj në fushën e jurisprudencës. Para se të merrte postin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Elira Kokona ka ushtruar detyrën si Drejtore Ekzekutive e Shkollës Kombëtare të Avokatisë në Shqipëri. Ajo zotëron shumë mirë anglishten, frengjishten, italishten dhe mjaftueshëm spanjishten. Aktualisht është doktorante në Universitetin e Tiranës Fakulteti i Drejtësisë.

Keshilltar

Milena Selimi. Me një eksperiencë të pasur si gazetare, përkthyes, skenariste dhe shkrimtare, si dhe përvojë menaxhimi në media si Drejtore në Kanal 2 të Radio Tiranës, Kryeredaktore në revistat “Kult” dhe “Jeta”, kryeredaktore e Radio Tiranës (seksioni i mbrëmjes). Editore përgjegjëse për redaksinë e kulturës në media të ndryshme. Ka bashkëpunuar në Organizata Kombëtare e Ndërkombëtare si korrespondente, koordinatorë, moderatore dhe anëtare jurie në fushën e gazetarisë, filmit dhe kritikës si: TIFF, Çmimet KULT, Festivali POETIKA, Balkan Media Magazine, etj. Pjesëmarrëse në aktivitete dhe panele të ndryshme që lidhen me zhvillimet e gazetarisë, dramaturgjisë dhe përkthimit, brenda dhe jashtë vendit si TRADUKI, “Writer-in-Residence-Programm”-Kroaci, “First Translation Workshop”-Sremski Karlovci-Novi Sad, “Translator-in-Residence-Programm”-Sarajevë, Festivali “Fantasio”-Trento, etj. Përkthyes në shqip e autorëve Nikola Madzirov, Alek Popov, Edo Popoviç, si dhe pjesëmarrëse si përkthyes në “Antologjinë Ballkanike”, botuar nga Goethe Institut-Sarajevë, me tregime të autorëve ballkanas, etj. Ka mbaruar Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë –Dega Gjuhë-Letërsi shqipe/Tiranë dhe Universitetin “Kliment Ohridski” Sofje - Specializim 6-mujor në Gazetari Televizive (janar 1997-korrik 1997). Zotëron gjuhët Italisht, Bullgarisht, Maqedonisht.

Keshilltar

Edmond Ahmeti. Studime të avancuara dhe aftesi praktike të gjera në fushën e të drejtave të autorit dhe pronësisë intelektuale, është në përfundim të studimeve doktorale. Eksperiencë të konsoliduar në fushën e avokatisë sidomos në fushën e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore. Ka punuar si jurist në Byronë Shqiptare të Sigurimeve ku është marrë kryesisht me përfaqësimin e këtij institucioni në gjykatë me specifikë paditë e regresit. Ka dhënë një kontribut të rëndësishëm prej disa vitesh si këshilltar ligjor në studion “Këshillime Ligjore”, një nismë vullnetare, ku qëllimi kryesor është këshillimi ligjor pro bono. E njeh mirë sferën e biznesit dhe klimën e biznesit në Shqipëri ku prej vitit 2009 – 2012 ka mbajtur pozicionin e drejtorit të shitjeve dhe të marketingut në një shoqëri private. Ka studiuar drejtësi në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Drejtësisë me rezultate shumë të mira. Gjatë studimeve, ai ka bashkëthemeluar një organizatë studentore për të promovuar të drejtat e studentëve. Profilit të tij si jurist i shtohet dhe angazhimi akademik, ku prej më shumë se 4 vite është lektor në një prej universiteteve jopublike në disiplinën e : E drejtë biznesi, Pronesi Intelektuale, Procedurë Civile. Ka marrë pjesë në një sërë konferencash shkencore ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit . Si i perzgjedhur i programit Lead Albania- AADF mbulon ceshtjet e të drejtave të autorit dhe ceshtje të tjera juridike pranë Kabinetit. Flet gjuhët Anglisht dhe Italisht.